



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2021:087634

Datë: 04.06.2024

Numri i dokumentit: 05775131

2021:087635

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm Civil - gjyqtari Faton Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Besart Selmani, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: N.K. nga Ferizaj; S.L. nga fsh ..., Komuna e Vitisë, A.R. nga Ferizaj, Z.F. nga Ferizaj dhe B.V. nga Ferizaj, të cilët me autorizim i përfaqëson avokat Rafiz Shehu me adresë në Ferizaj, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë – Drejtoria Rajonale në Ferizaj, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës përfaqësuesja Z.M.G., me objekt kontesti kompensim i pagave të trembëdhjeta, me lartësi të objektit të kërkesës 10,603.96€, gjykata jashtë seancës gjyqësore, me datë 03 Qershor 2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve N.K. nga Ferizaj; S.L., A.R., Z.F. dhe B.V., si e bazuar.

II. DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë – Drejtoria Rajonale në Ferizaj, që paditësve:

- **N.K.** me numër personal të letërnjoftimit ..., që në emër të shpërblimit të pagës së (13-të) trembëdhjetë, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguaj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 2,260.84 € (dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë, tetëdhjetë e katër euro). Shumën e gjykuar t'ia paguaj paditësit, me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë dt. 07.05.2021 e deri në pagesën definitive.
- **S.L.** me numër personal të letërnjoftimit ..., që në emër të shpërblimit të pagës së (13-të) trembëdhjetë për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguaj shumën e përgjithshme të mjeteve prej: 2,253.00€ (dy mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre euro). Shumën e gjykuar t'ia paguaj paditësit, me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë dt. 07.05.2021 e deri në pagesën definitive.

- **A.R.** me numër personal të letërnjoftimit ..., që në emër të shpërblimit të pagës së (13-të) trembëdhjetë për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguaj shumën e përgjithshme të mjeteve prej: 2,031.76€ (dy mijë e tridhjetë e një, shtatëdhjetë e gjashtë euro). Shumën e gjykuar t'ia paguaj paditësit, me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë dt. 07.05.2021 e deri në pagesën definitive.
 - **Z.F.** me numër personal të letërnjoftimit, që në emër të shpërblimit të pagës së (13-të) trembëdhjetë për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguaj shumën e përgjithshme të mjeteve prej: 2,245.16€ (dy mijë e dyqind e katërdhjetë e pesë, gjashtëmbëdhjetë euro). Shumën e gjykuar t'ia paguaj paditësit, me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë dt. 07.05.2021 e deri në pagesën definitive.
 - **B.V.** me numër personal të letërnjoftimit, që në emër të shpërblimit të pagës së (13-të) trembëdhjetë për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguaj shumën e përgjithshme të mjeteve prej: 1,789.68€ (një mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë, gjashtëdhjetë e tetë euro). Shumën e gjykuar t'ia paguaj paditësit, me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë dt. 07.05.2021 e deri në pagesën definitive.
- Po ashtu detyrohet e paditura të paguaj edhe shpenzimet e kësaj procedure kontestimore, në shumën prej 725 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

III. REFUZOHET - pjesa e kërkesëpadisë së paditësve me të cilën kanë kërkuar që paditësve **N.K.** që në emër të pagës së 13-të, për vitin 2022, t'ia paguaj shumën prej 565,21 euro; **S.L.**, që në emër të pagës së 13-të, për vitin 2022, t'ia paguaj shumën prej 563,25 euro; **A.R.**, që në emër të pagës së 13-të, për vitin 2022, t'ia paguaj shumën prej 507,94 euro; **Z.F.**, që në emër të pagës së 13-të, për vitin 2022, t'ia paguaj shumën prej 561,29 euro; **B.V.** që në emër të pagës së 13-të për vitet 2019 dhe 2022 t'ia paguaj shumën prej 1,193.12 euro, si dhe pjesa e kërkesëpadisë së paditësve me të cilën kanë kërkuar që paditësve tu paguhet shumat si në vijim: paditësit **N.K.**, në emër të pagës jubilarë ti paguhet shuma prej: 141.30€, që në emër të shpenzimeve të ushqimit – shujtës për periudhën nga data 14.11.2018 deri më 30.04.2021, për 534 ditë, t'ia paguaj shumën prej 1869.00€; paditësit **S.L.**, në emër të pagës jubilarë ti paguhet shuma prej: 140,81€, që në emër të shpenzimeve të ushqimit – shujtës, për periudhën nga data 14.11.2018 deri më 30.04.2021, për 534 ditë, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1869.00€; paditëses **A.R.**, në emër të shpenzimeve të ushqimit – shujtës për periudhën nga data 21.01.2019 deri më 30.04.2021 për 335 ditë, t'ia paguaj shumën prej 1172.50€; Paditësit **Z.F.** në emër të pagës jubilarë ti paguhet shuma prej: 140.32€, që në emër të shpenzimeve të ushqimit – shujtës për periudhën nga data

14.11.2018 deri më 30.04.2021 për 534 ditë, t'ia paguaj shumën prej 1869.00€; Paditësit B.V. në emër të pagës jubilarë ti paguhet shuma prej: 149.14€, që në emër të shpenzimeve të ushqimit – shujtës për periudhën nga data 14.11.2018 deri më 30.04.2021 për 534 ditë, t'ia paguaj shumën prej 1869.00€; **si e pabazuar.**

IV.DETYROHET e paditura që në emër të diferencës së taksës gjyqësore për padi të paguajë shumën prej 70€, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre, me datën 07.05.2021, ka paraqitur padi kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë – Drejtoria Rajonale në Ferizaj, me të cilën ka kërkuar pagesën e shpenzimeve të shujtës, shpërblimin jubilar dhe pagat e 13-ta, për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

Më tej, në padi ka theksuar se paditësit kanë themeluar marrëdhënie pune në Stacionin Policorë në Ferizaj, si në vërtetimet e bashkangjitura dhe që nga ajo kohë vazhdojnë të jenë të punësuar në këtë institucion në pozitën e njëjtë. Paditësit edhe pse janë të punësuar në këtë institucion dhe kanë kryer gjithmonë në përpikëri detyrat e tyre, kanë marrë gjithmonë vlerësime të kënaqshme dhe asnjëherë nuk ka qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore dhe ndonjëse grada dhe kualifikimi i përvojës së punës i njeh të drejtën në shpërblim të një page në fund të vitit ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, të drejtën për shujtë ditore si dhe shpërblimi jubilar, të cilat i parasheh udhëzimi administrativ nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës policinë e Kosovës, neni 29 par 2 të Udhëzimit administrativ me nr. 02/2018, i cili ka hyrë në fuqi me datën 14.11.2018 i cili thekson „Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit,, një gjë të tillë nuk e kanë realizuar.

I autorizuari i paditësve, përmes parashtrësës me shkrim më datë 12.10.2023 ka bërë precizimin e kërkesë padisë dhe zgjerimin e saj duke kërkuar nga gjykata që paditësve t'iu aprovohet padia dhe kërkesë padia dhe të detyrohet e paditura që paditësve t'ia kompensoj shpërblimin të një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022. Ndërsa sa i përket kërkesë padisë për pagesën e një page jubilarë për të gjithë paditësit bënë tërheqjen e padisë ngase ka deklaruar se janë realizuar

pagesat dhe për pagesën e shujtave ditore për ditët e kaluara në punë, me kamatë ligjore 8% nga momenti i paraqitjes së padisë bënë tërheqjen e padisë sa i përket këtyre pjesëve. Andaj ka kërkuar që të aprovet padia dhe kërkesë padia e paditësve si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura nëpërmjet të autorizuarit të saj, ka paraqitur përgjigje në padi, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve me arsyetimin se paditësit nuk i kanë shterur mjetet brenda institucionit. Ka deklaruar se nuk është kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura duke u mbështetur në vërtetimet e punësimit të lëshuara nga e paditura. Më tutje ka kundërshtuar edhe kërkesëpadinë e paditësve për sa i përket kompensimit të pagës së 13-të, pasi që nuk është realizuar për asnjë punonjës të Policisë së Kosovës, për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Ministria e Financave në përputhje me nenin 19 të Ligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, përkatësisht Ligjin nr. 05/L-1125, neni 20 par 3 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe ri rrjedhoje e kësaj çdo veprim apo nismë, duke përfshirë edhe nenin 29 pika 2 të UA.nr.02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore – financiare nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të për asnjë zyrtarë policor. Sa i përket pagesës së shpërblimit jubilar, paditësit janë paguar për shpërblim jubilar, 25% të pagës mesatare konform nenit 29.5 të UA 02/2018. Gjithashtu sa i përket kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e shujtave, për çdo vit kalendarik e pasi kjo vlen vetëm në bazë të mundësive ligjore, financiare dhe institucionale të paditurës dhe asnjë dispozitë ligjore nuk e parasheh si detyrim, andaj e njëjta nuk mund të jetë obligim i të paditurës.

Lidhur me paditësin B.V. përmes përgjigjes në padi e ka njoftuar gjykatën se i njëjti ka qenë subjekt i shqiptimit të masës disiplinore më datë 26.07.2019 sipas urdhëresës për ekzekutim lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës nga e cila shihet se paditësit i është shqiptuar masë disiplinore për shkelje të rëndë disiplinore. Andaj kjo masë disiplinore paraqet pengesë për kompensimin e pagës së 13-t për kohën sa masa ka qenë në fuqi nga 26/7/2019 deri më 25/7/2021.

Shpenzimet e procedurës nuk i kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja

faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë.

Ndërsa për pjesën tjetër të kërkesëpadisë, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 399 sipas të cilit “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 398 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Udhëzimet administrative 02/2018 dt. 14.11.2018 dhe 01/2021 dt. 29.09.2021 të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata pas analizimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqës, konstaton se në mes tyre është kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstaton se në mes të palëve ndërgjyqës nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë fakt e vërtetoi sipas vërtetimeve të punësimit të paditësve të bashkangjitura në shkresa të lëndës.

Nga vërtetimi i punësimit me nr. 04/... të datës 13.04.2021, të lëshuar nga MPB– Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për paditësin N.K., gjykata ka vërtetuar se paditësi është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga data e 01.08.2005 me pagë momentale 565,21€, për një muaj kalendarik.

Nga vërtetimi i punësimit me nr. 04.... të datës 13.04.2021, të lëshuar nga MPB– Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për paditësin S.L., gjykata ka vërtetuar se paditësi është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga data e 22.09.2003 me pagë momentale 563,25€, për një muaj kalendarik.

Nga vërtetimi i punësimit me nr. 04/.... të datës 13.04.2021, të lëshuar nga MPB–Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për paditësen A.R., gjykata ka vërtetuar se paditësi është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga data e 21.01.2019 me pagë momentale 507,94€, për një muaj kalendarik.

Nga vërtetimi i punësimit me nr. 04/.... të datës 13.04.2021, të lëshuar nga MPB–Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për paditësin Z.F., gjykata ka vërtetuar se paditësi është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga data e 27.09.2004 me pagë momentale 561,29€, për një muaj kalendarik.

Nga vërtetimi i punësimit me nr. 04/.... të datës 13.04.2021, të lëshuar nga MPB–Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për paditësin B.V., gjykata ka vërtetuar se paditësi është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga data e 28.02.2005 me pagë momentale 596,56€, për një muaj kalendarik.

Bazuar në provat e bashkangjitura në padi, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, si dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë. Po ashtu bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 213/2023 të datës 09.10.2023, për shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në policinë e Kosovës. Në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 ku përcaktohet se: “I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”. Në nenin 44 par.2 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë përcaktohet se: “Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”. Ndërsa neni 55 par.1 nënpar.1.7 i këtij Ligji përcakton se: “Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”. Në nenin 5 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, përcaktohet se në nenin 29 paragrafi 2 të këtij udhëzuesi është paraparë se “Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”, ndërkaq bazuar edhe në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 213/2023 të datës 09.10.2023, për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në policinë e Kosovës është paraparë se “në kontestet nga marrëdhëniet e punës - lidhur me kërkesat për shpërblimin e pagës së 13-të, për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë

paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë të nenit 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021”. Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësve si të punësuar pranë saj që të ia paguaj pagën e 13 për çdo fund vit për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 pasi që janë plotësuar edhe kushtet nga ana e paditësit siç parashihen në nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, më saktësisht vlerësimet për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 ka qenë plotësisht të kënaqshme, e po ashtu ndaj të njëjtëve nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore. Nga interpretimi i dispozitave të Udhëzimeve Administrative 02/2018 dhe 01/2021, të nxjerra nga e paditura dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve sa i përket pagave të 13-ta është në tersi e bazuar sepse paditësja e gëzon të drejtën që në fund të çdo viti kalendarik, ta përfitoj si shpërblim, një pagë mujore, e cila pagë do të jetë e njëjtë me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, me kusht që atë vit kalendarik punonjësit e të paditurës në këtë rast paditësit, të kenë vlerësim të kënaqshëm të performancës së punës dhe nëse nuk ju është shqiptuar ndonjë masë disiplinore brenda vitit përkatës.

Në këtë rast sipas formularëve të vlerësimit, që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet se paditësit i plotësojnë kushtet e përshkruara dhe kanë vlerësime të kënaqshme të performancës dhe të njëjtëve nuk i janë shqiptuar ndonjë masë disiplinore, përgjatë viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Për më tepër e paditura nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje me anë të përgjigjes në padi, e që do të vinte në dyshim performancën e paditësve për vitet e kaluara, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj paditësve përveç paditësit B.V. i cili është dëshmuar edhe me prova se ka qenë subjekt i masës disiplinore. Ashtu që gjykata vlerëson se paditësit kanë të drejtë që të kërkojnë pagën e 13-të, duke u mbështetur edhe në dispozitat nën – ligjore respektivisht Udhëzimin Administrativ të cekur më lartë i cili në mënyrë të qartë e përcakton të drejtën e paditësve për të kërkuar pagat të përshkruara në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese për kërkesën e palës që në emër shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitin 2022, t’ia paguaj për shumat si në pjesën refuzuese, Gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, pasi Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, në nenin 30 paragrafi 2 të këtij udhëzuesi është paraparë se

“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit nëse ka mjete buxhetore, . Pastaj bazuar edhe në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 213/2023 të datës 09.10.2023, për shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në policinë e Kosovës është paraparë se “në kontestet nga marrëdhëniet e punës - lidhur me kërkesat për shpërblimin e pagës së 13-të, për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë të nenit 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021”. Andaj bazuar në mendimin juridik, është përcaktuar në mënyrë shprehimore se çështja e kompensimit të pagës së trembëdhjetë (13) për vitin 2022, për personelin e policisë është e kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, respektivisht nëse ka mjete buxhetore. Pra, e drejta e punëmarrësit (paditësit) për të realizuar pagën e trembëdhjetë (13) për vitin 2022, krijohet kur punëdhënësi (e paditura) nuk e përmbushë atë, ndërsa nuk arrin të provojë se nuk ka pasur mundësi buxhetore. Së këndejmi, në përgjigjen në padi, e paditura në mënyrë konkrete ka sqaruar se nuk kanë pasur mundësi buxhetore për të realizuar pagën e trembëdhjetë (13) për personelin e policisë. Andaj, gjykata vlerëson se dispozita ligjore e nenit 30 par. 2 të Udhëzimit Administrativ të datës 29.09.2021, nuk është e karakterit detyrues për palët kontraktuese. Kështu, duke u mbështetur edhe në mendimin juridik nr. 213/2023 të datës 09.10.2023, duke qenë se të provuarit e faktit nëse ka mundësi buxhetore i ka takuar të paditurës, e njëjta me përgjigjen në padi të datës 20.11.2023, ka provuar se nuk ka mundësi buxhetore për të kompensuar pagën e trembëdhjetë (13) ndaj paditësit. Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese për kërkesën e paditësit B.V. që të kompensohet paga e 13-të për vitin 2019 , vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija” kjo bazuar në provën e paraqitur nga e paditura në përgjigjen në padi me të cilën paditësit B.V. në vitin 2019 i është shqiptuar masa disiplinore për shkele të rënda në punë e që bie ndesh me kriteret e përcaktuara në 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018.

Sa i përket pjesës së refuzuar të kërkesëpadisë, për pagën jubilarë dhe shujtës, gjykata vendimin e saj e bazoi në parashtrësën e palës së paditur të datës 12.10.2023, me të cilën i autorizuari e paditësve e ka njoftuar gjykatën se heq dorë nga kërkesëpadia e paitësve sa i përket pagës jubilarë dhe shujtës.

Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për shpërblimin e pagës së 13-të në fund të viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021, në rastin konkret për paditësit N.K., S.L., A.R. dhe Z.F., ndërsa për paditësin B.V. për vitet 2018, 2020, 2021 gjykata mori për bazë vërtetimin e punësimit të lartshënuar në të cilin shënohet sa e kanë pagën secili nga paditësit, e nga e cilat rezulton paga të cilën e realizon paditësit dhe përvojën e punës tek e paditura, pastaj raportet e punës përkatësisht vlerësimet dhe raportet për masa disiplinore, andaj paditësve ju njoh e drejta në kompensim ashtu si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, vlerëson se e paditura ka detyrim sipas dispozitave të lartpërmendura, që t'i kompensoj paditësve pagat e trembëdhjeta pasi duke u bazuar në nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-s), në të cilin përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë që ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*. Prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditësit me aplikimin e dispozitave të lartcekura dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve t'ua kompensoj shumat e gjykuara si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumat përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë me datë 07/05/2021 bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe duke pas parasysh edhe faktet jokontestuese nga palët ndërgjyqës në këtë çështje kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe të njëjtën e ka aprovuar sikurse në pikën I. dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që nga provat e paraqitura ka vërtetuar faktin se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura. Lartësia e kërkesëpadisë u mbështet në listën e pagave përmes të cilës u vërtetua shuma se sa janë paguar paditësit, andaj kjo ishte baza për llogaritjen e pagave për katër vitet (e cila del nga llogaritja e thjeshtë për paditësin N.K. nga paga bazë 565,21 x 4

vite = 2,260.84euro; Për paditësin S.L. nga paga bazë 563.25 x 4 vite = 2,253.00 euro; Për paditësin A.R. nga paga bazë 507.94 x 4 vite = 2,031.76 euro; Për paditësin Z.F. nga paga bazë 561,29 x 4 vite = 2,245.16euro; për paditësin B.V. nga paga bazë 596.56 x 3 vite = 1,789.68euro) andaj edhe këto përllogaritje për gjykatën kanë qenë të sakta dhe reale, ngase vetë kërkesa e paditësve ka qenë e tillë dhe gjykata ka vlerësuar se nuk ka nevojë për nxjerrjen e ekspertizës sipas detyrës zyrtar, për përllogaritjen e të njëjtës.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi sa i përket pjesëve të aprovuara të kërkesë padisë dhe gjeti se të njëjtat janë pjesërisht të bazuara. E paditura nuk mund ta mënjanoi detyrimin, me pretendimin se detyrimet financiare nga Udhëzimi Administrativ se nuk prodhojnë efekt për shkak se janë në harmoni me Ligjin mbi ndarjet buxhetore, gjykata vlerëson se këto akte, në këtë rast Udhëzimet Administrative të lartcekura, janë aprovuar nga struktura të larta të paditurës, e të cilët e kanë pasur për qëllim edhe motivimin e punonjësve për punë kur edhe kanë përcaktuar shpërblime për të njëjtit. Për më tepër derisa ato janë qartë të specifikuara nuk mund të interpretohen në dëm të tani paditësit duke u thirrur në mos ekzistimin e mundësive financiare, e as nuk mund të mbetet në diskrecionin e të paditurës se a mundet a po jo për tu përmbushur detyrimet që rezultojnë nga dispozitat lartcekura, përderisa e paditura me asnjë provë shkresore – analizë buxhetore, nuk e argumenton faktin se ka mungesë të mjeteve buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç kanë kërkuar paditësja, për pjesën e aprovuar të kërkesës.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e bazoj në dispozitën e nenit 449 dhe 452, të LPK-së, sipas të cilave paditësit i pranohen shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në emër të përpilimin të padisë shumë prej 624 euro dhe në emër të taksës gjyqësore në shumë prej 101€ gjithsejtë shumë prej 725 euro, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit, ndera pjesa tjetër e shpenzimeve të procedurës së kërkuar u refuzua si e pa bazuar.

Nga se u tha me lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil

2021:087635, me datë 03 Qershor 2024

Gjyqtari
Faton Ajvazi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.